



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:133360

Datë: 28.01.2021

Numri i dokumentit: 01452286

C.nr.1088/2020

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike kontestimore te paditësës S.S rr.”...” ... nr. ..., Prishtinë, kundër te paditurës S... në Mitrovicë të cilën e përfaqëson L.B-Sh e Zyrës Ligjore, më objekt kontesti, kompensimi të pagesës së shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 803.01 euro, pas mbajtjes se seancës kryesore publike me datë 28.01.2021, me datë 28.01.2021 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësës S.S nga Prishtina, kundër të paditurës S... në Mitrovicë, si e bazuar;
- II. OBLIGOHET** e paditura S... në Mitrovicë që paditësës S.S, në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të përvojës së punës, t’ia kompensoi 1 (një pagë) në shumën e përgjithshme prej 803.01 euro (me fjalë: tetëqind e tri euro e një cent) në afatin shtatë (7) ditësh, nga dita e pranimit te aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm.
- III. OBLIGOHET** e paditura S... që në emër të shpenzimeve procedurale, t’ia kompensoj paditësës shumën e përgjithshme prej 20 euro (me fjalë: Njëzet euro), ne afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e pranimit te aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësja me datën 13.10.2020 ka ushtruar padi, më të cilën ka kërkuar shpërblimin jubilar për 10 (dhjetë) vite të përvojës së punës në vlerë të një page dhe atë shumën e përgjithshme prej 803.01 euro, konform nenit 17 paragrafi 3 dhe 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018.

Gjykata, me datën 28.01.2021, ka caktuar dhe ka mbajtur seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar paditësja dhe përfaqësuesja e të paditurës.

Paditësja, gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se mbetet pran padisë dhe kërkesëpadisë të ushtruar me shkrim, paga baze të cilën e realizojë është 803.01euro, kjo vërtetohet edhe nga lista e pagës, mirëpo në listën e pagës janë të përcaktuara edhe shtesat tjera kujdestarit, shujtat e të cilat në nuk i kemi përlllogaritur me lartësinë e pagës por kemi përlllogarit vetëm pagën baze dhe përvojën e punës që i shtohet pagës baze e që ka vlerën totale në shumën e lartcekur, shpenzimet e procedurës i kërkojë dhe atë për takse për padi 20 euro, sa i përket kamatës ligjore në të njëjtën nuk e kërkojmë.

E paditura, nëpërmes së autorizuarës së vetë, nuk e kontestoi bazën juridike të padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se menaxhimet i spitalit e ka refuzuar kërkesën e paditëses në mungesë të mjeteve të planifikuara buxhetore, nuk e kundërshtoi lartësinë e pagës e as përvojën e punës.

Gjendja faktike e vërtetuar

Më qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor me propozimin e palëve ndërgjyqëse, administroi provat si në vijim: Vendimi i të paditurës i dt.06.10.2020, Vërtetimi i lëshuar nga QKMF – Fushe Kosove i dt.18.01.2007, Vërtetimi lëshuar nga e paditura e dt.09.10.2020, Lista e Pagës për muajin Shtator 2020, Vendimi Lëshuar nga Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dt.08.10.2007, Kopja e letërnjoftimit të paditëses, Certifikata lëshuar nga Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dt.23.05.2012, Vendimi Lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dt.08.10.2007.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën Kontestimore (tash e tutje referuar si LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbi këtë bazë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditësit **është në tërësi e bazuar**.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga QKMF- Fushe Kosove datës 18.01.2007 me të cilën vërtetohet se paditësja ka qene në marrëdhënie pune prej dt.01.08.2005 e deri me 31.05.2006, po ashtu nga Vërtetimi lëshuar me dt.09.10.2020 me numër të protokollit 1809 i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm “...” në Mitrovicë ku vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga data 04.09.2012. Po ashtu, Vërtetimi lëshuar nga Qeveria e Kosovës i dt.08.10.2007 po ashtu Certifikata e lëshuar nga Qeveria e Kosovës- Ministria e Shëndetësisë i dt.23.05.2012, si dhe nga vendimi i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dt.08.10.2007.

Nga vërtetimet e lartshënuara mbi përvojën e punës, si dhe nga kontrata në fjalë, gjykata ka konstatuar se paditësja është në marrëdhënie pune të pandërprerë tek e paditura për më shumë se 10 vite, po ashtu provoja e punës nuk është kontestuar as nga e paditura.

Paditësja më datën 02.10.2020 i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e një page bazë në emër të shpërblimit jubilar.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në bazë të pasqyrës së pagës të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës të muajit Shtator 2020, lidhur me lartësinë e pagës bazë.

Baza ligjore

Me nenin 4 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës parashihet se “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Ndërsa, në nenin 90 i këtij ligji parashihet se “1. Marrëveshja kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. në nivel të vendit, 2.2 nivel të degës; 2.3. nivel të ndërmarrjes. 3. Marrëveshja Kolektive mund të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”.

Me nenin 4 paragrafi 1, të Kontratës Kolektive Sektoriale, (tash e tutje referuar si “Kontrata Kolektive”) parashihet që “KKS-ja gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tërësor”, dhe paragrafi 2 “Fushë zbatimi i KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucione shëndetësore”.

Gjithashtu, me nenin 17 paragrafi 3 i Kontratës Kolektive parashihet se “punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, [...] për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”. Kurse, paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton se “Punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja ishte dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie pune tek e paditura. Nuk ishte kontestues as fakti se e njëjta ka pasur përvojë pune për me shumë se (10) vite. Megjithatë, kontestuese ishte mungesa e mjeteve buxhetore të planifikuara për këtë kategori.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovohet në tërësi si e bazuar. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësja ka qenë dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se paditësja ka përvojë pune mbi njëzet (10) vite tek e paditura. Në rastin konkret, gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje vlerësoi nenin 4 paragrafët 1 dhe 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, përmbajtja e të cilëve u paraqit më lartë.

Gjykata vendimin e vet e bazoi në nenin 17, paragrafin 3, pika 1 të Kontratës Kolektive Sektoriale e cila përcakton se “punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë, [...] 3.1. për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësor, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”. Ky vendim u bazua edhe në lidhshmëri me provën, përkatësisht vërtetimet të lëshuar nga e paditura, të datës 09.10.2020 si dhe nga Vërtetimi i QKMF “...” Fushe Kosove i datës

18.10.2007, Certifikata lëshuar nga Qeveria e Kosovës Ministria e Shëndetësisë e dt.23.05.2012 si dhe nga Vendimi i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë e dt.08.10.2007. Në provat e sipërshënuara është specifikuar edhe përvoja e punës së paditëses, nga e cila rezulton që paditësja ka përvojë pune tek e paditura, për më shumë se (10) vite përvojën pune. Rrjedhimisht, të paditurës i takon kompensimi i vetëm një page jubilarë në shumë prej 803.01 euro.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarës të të paditurës, duke e kontestuar kërkesëpadinë e paditëses vetëm për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoi si të pa bazuara për faktin se, bazuar në ligjet në fuqi është një e drejtë e cila i takon palës paditëse si dhe gjykata vendimin e saj e bazoi në nenin 17 paragrafi 4 të Kontratës Sektoriale të Shëndetësisë, ashtu që vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve në shumën prej 20 euro te taksës per padi. Gjkata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 paragrafin 1 te LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.1088/2020, më datë 28.01.2021

GJYQTARI
Naim Mehulli

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.